

SEMINARI NDËRKOMBËTAR PËR GJUHËN, LETËRSINË DHE KULTURËN SHQIPTARE

FAKULTETI I FILOLOGJISË I UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS

Prishtinë, Rruga Nënë Tereza, pn. KOSOVË Tel. +38138 222 970

E-mail: seminari.filologjik@uni-pr.edu , shkumbin.munishi@uni-pr.edu

Drejtor: Prof. dr. Shkumbin Munishi

Bashkëdrejtore: Prof. dr. Dhurata Shehri

Sekretar: Prof. asoc. dr. Anton Berishaj

Bashkësekretare: Prof. asoc. dr. Linda Mëniku

Sekretarë profesionalë: Dr. Kadire Binaj dhe MA. Mensur Vokri

Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare është themeluar në vitin 1974 pranë Fakultetit të Filologjisë (atëherë: Fakulteti Filozofik) të Universitetit të Prishtinës. Ky Seminar organizohet për studiues e studentë që merren me probleme të gjuhës, të letërsisë e të kulturës shqiptare, po edhe me albanologjinë përgjithësisht.

Seminari ka zhvilluar gjithsej tridhjetë e tetë sesione. Në vitet 1995 e 1996 sesionet e këtij Seminarit u mbajtën në Tiranë në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë e të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Sesionet 19 dhe 20 (2000-2001) janë organizuar në bashkëpunim me Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

SEMINARI XXXIX DO T’I ZHVILLOJË PUNIMET NË PRISHTINË NGA 23 gusht – 3 shtator 2021.

Arritja e seminaristëve në Kosovë, më 22 gusht 2021 (e diel). Hapja solemne e Seminarit XXXIX, më 23 gusht 2021, në orën 11:00.

Programi bazë i Seminarit XXXIX:

1. Kurse intensive të mësimit të shqipes (tri nivele);
2. Ligjërata të veçanta të gjuhësisë;
3. Ligjërata për letërsinë shqiptare;
4. Ligjërata për kulturën shqiptare;
5. Tryeza;

6. Referime shkencore;
7. Program kulturor plotësues për t'i njohur seminaristët me bukuritë natyrore dhe historinë, si dhe me veprimtaritë kulturore në vende të ndryshme të Kosovës.

SESSIONET SHKENCORE (2 – 3 Shtator 2021)

Temat bosht të Seminarit për sesionet shkencore (2 – 3 Shtator 2021) janë:

I. Gjuhësi:

1. Struktura e shqipes së vjetër

Në zhvillimin e saj historik gjuha shqipe ka ndërtuar tiparet e saj strukturore, të cilat në të kaluarën kanë qenë objekt studimi i shumë studimeve historike-krahasimtare. Në sesionin e sivjetmë të Seminarit do të diskutohen përsëri aspektet e ndryshme që kanë të bëjnë me strukturën e shqipes së vjetër, ashtu siç del e pasqyruar në shkrimet e vjetra, dhe tiparet strukturore të saj. Inkurajohen pjesëmarrësit që në studimet e tyre të trajtojnë çështje e probleme konkrete strukturore që lidhen me sistemin e shqipes së vjetër.

2. Shqipja dhe varietetet e saj

Shqipja e sotme ka manifestime varietetesh e formash të ndryshme gjuhësore të cilat kanë mbështetje të ndryshme gjeografike, shoqërore e kulturore. Në kuadër të kësaj teme pjesëmarrësit janë të ftuar të trajtojnë çështje shumëdimensionale që lidhen me varietetet e shqipes, me strukturën, funksionet dhe përdorimet e tyre.

II. Letërsi:

1. Letërsia shqipe: vetmia dhe veçimi

Këto topika të forta të letërsisë universale me prani të gjithëkohëshme në letërsi, kanë lënë gjurmë e janë bërë produktive edhe në letërsinë shqipe. Një hetim i gjurmëve dhe relacioneve me topikën, poetikën, periudhat, autorët dhe gjinitë e letërsisë shqipe është i mundur. Vetmia dhe veçimi shfaqen edhe si gjendje e parakushte të krijimit në përgjithësi dhe atij letrar në veçanti.

Duke u nisur nga këto dy prerje të mëdha, letërsia shqipe mund të hetohet e interpretohet nën dritën e:

- a. Vetmisë si parakusht i kërkimit, zbulimit dhe krijimit të vetvetes dhe botës;
- b. Vetmisë dhe veçimit si ndërtim e zotërim i vetvetes dhe i identitetit personal;
- c. Veçimit prej shoqërisë si distancë higjienike prej “tjetrit” (edhe ai i zbulueshëm pikërisht prej vetmisë dhe veçimit) për të zbuluar kufijtë e vetvetes;
- d. Mungesës së veçimit social si parakusht e produkt i letërsisë së masës;
- e. Vetmisë dhe veçimit të individit krijues nga shoqëria, dukuri e “izma-ve” letrare të shekullit XX, edhe në letërsinë shqipe.

2. Mësimdhënia e letërsisë për nxënësit e mijëvjeçarit të ri

Kjo temë ka në qendër idenë e mësimdhënies së letërsisë në një brez të ri nxënësish që konsiderohen "të lindur" me teknologjitë të reja, pra nxënësit e mijëvjeçarit të ri të cilët kanë një qasje krejt të ndryshme me librin e leximet nga mësuesit e tyre, por edhe në përgjithësi me "emigrantët", siç quhen të gjithë ata individë që teknologjitë e reja i kanë mësuar dhe janë adoptuar me to që në moshë të vogël. Nisur nga kjo premisë, edhe mësimdhënia e letërsisë ka reflektuar e po reflekton në botë. Po në arealet shqipfolëse si rezulton kjo qasje në të gjitha nivelet: të programeve, të teksteve, të mësuesve, si dhe të programeve të masterave që diplomojnë mësues letërsie?

Rasti i mësimdhënies digjitale gjatë periudhës së pandemisë, më shumë se një vit në të gjitha nivelet e mësimdhënies së letërsisë mund të shërbejë si një casus për të analizuar disa prej çështjeve të sipërpërmendura.

III. Kulturologji:

1. Roli i medias në periudhën e infodemisë

Fjalën 'infodemi' që për herë të parë në 2003 e ka përmendur një artikull i Washington Post-it, e ka ripërdorur Organizata Botërore e Shëndetësisë në shkurt të vitit të kaluar si 'infodemi masive', që po e shoqëron shpërthimin e pandemisë të Covidit. Ky term për OBSH-në nënkupton vërshimin e madh të informatave rreth virusit, një pjesë e të cilave nuk janë ta sakta dhe e vështirësojnë gjetjen e burimeve të verifikuara për publikun.

Në periudhën e post-së-vërtetës, diskursit popullist, dhe zhvillimit marramendës të teknologjisë digjitale, po bëhet gjithnjë më e vështirë të dallohen informacionet faktike nga propaganda. Dezinformatat për coronavirusin po shpërndahen po aq shpejt sa edhe vetë virusi, duke filluar prej ilaçeve mrekullibërëse të mjekësisë alternative e deri te aktivizmi për anti-vaksinim dhe teoritë e konspiracionit. Lajmet e rreme që shpesh janë të dorës së dytë apo të tretë, bëhen virale sidomos nëpër rrjetet sociale, dhe pakkush nga publiku ua kushton ato 20 sekonda të larjes së duarve edhe verifikimit të burimit apo kërkimit të thjeshtë në Google. Infodemia shkakton efekt të fuqishëm emocional duke i lënë anash gjykimin racional dhe mendimin kritik.

Cili është roli i medias në këtë kaos infodemik?

2. Fake news në epokën e vetëkomunikimit

Sot kemi kaluar tashmë nga epoka e komunikimit në atë të vetëkomunikimit, kur individët behën njëkohësisht edhe dhënës edhe marrës të mesazheve. Një nga problemet që shfaqet rëndom në këtë epokë vetëkomunikimi është fake news (lajmi i rremë) që është shndërruar në dukuri sot në botë. Mënyrat e hetimit dhe zbulimit të fake news, raporti i lajmit të rremë më mediet tradicionale dhe ato të reja, reagimi ndaj tij dhe pasojat që krijon në komunikim e vetëkomunikim mund të jenë disa nga këndvështrimet nga mund të shihet dukuria e fake news në epokën e vetëkomunikimit.

Abstraktet deri në 300 fjalë në shqip dhe në anglisht dorëzohen deri më 20 korrik 2021 në e-mail adresën seminari.filologjik@uni-pr.edu. Abstraktet duhet të përmbajnë temën dhe qëllimin e hulumtimit, sfondin

kërkimor dhe metodologjinë si dhe rezultatet e pritura. Po ashtu, luteni të shkruani një biografi të shkurtër dhe të specifikoni nëse aplikoni për sesion shkencor apo referim shkencor. Vlerësimi dhe përzgjedhja e punimeve bëhet deri më 25 korrik 2021.

Studiuesit nga Shqipëria duhet të aplikojnë në bashkëdrejtorinë e Seminarit në Tiranë (e-mail adresa: lindameniku@gmail.com).

Po ashtu, ftohen studiuesit të cilët nuk do të mund të jenë pjesë e Seminarit të sivjetmë dhe ta shpalosin punën e tyre shkencore, që t'i dërgojnë punimet e tyre për botim në revistën e Seminarit 39. Punimet të cilat duhet të përmbajnë abstraktin në shqip dhe anglisht dorëzohen deri më 1 dhjetor 2020 në e-mail adresën seminari.filologjik@uni-pr.edu.

Do të botohen vetëm punimet që janë vlerësuar të botueshme nga recensentët (blind peer review).

Drejtorja e Seminarit

THE INTERNATIONAL SEMINAR ON ALBANIAN LANGUAGE, LITERATURE AND CULTURE

FACULTY OF PHILOLOGY OF THE UNIVERSITY OF PRISHTINA

Mother Theresa, st, nn., Prishtina, KOSOVA Tel. +38138 222 970

E-mail: seminari.filologjik@uni-pr.edu ; shkumbin.munishi@uni-pr.edu

Director: Prof. dr. Shkumbin Munishi

Co-director: Prof. dr. Dhurata Shehri

Secretary: Prof. Asc. Dr. Anton Berishaj

Co-secretary: Prof. asoc. dr. Linda Mëniku

Professional Secretaries: Kadire Binaj, PhD and MA. Mensur Vokrri

The International Seminar on Albanian Language, Literature and Culture was founded in 1974 at the Faculty of Philology (Faculty of Philosophy at the time) of the University of Prishtina. This seminar is organized for researchers and students engaged in the Albanian sciences and in Albanology in general.

The Seminar has so far organized 38 Sessions. In 1995 and 1996, in co-operation with the Institute of Linguistics and Literature of the Academy of Sciences and Arts of Albania, the Seminar was carried out its activities in Tirana. The 19th and the 20th sessions were organized in cooperation with the Institute of Linguistics and Literature of the Academy of Sciences of Albania.

THE 39th SEMINAR WILL TAKE PLACE IN PRISHTINA FROM 23 August – 3rd September 2021.

The arrival of the participants in Kosovo, on August 22, 2021 (Sunday). The opening ceremony of the Seminar is on 23rd of August, at 11:00 am.

The basic program of the 39th Seminar:

1. Intensive Albanian learning courses (three levels);
2. Special linguistics lectures;
3. Lectures on Albanian literature;

4. Lectures on Albanian culture;
5. Round tables;
6. Scientific references;
7. Complementary cultural program to acquaint seminarians with natural beauties and history, as well as cultural activities in different parts of Kosovo.

COLLOQUIUM (2 - 3 September 2021)

The main topics for the Seminar's Colloquium (2– 3 September 2021) are:

I. Linguistics:

1. The structure of old Albanian

In its historical development, the Albanian language has built its structural features, which in the past have been the subject of study of many historical-comparative studies. In this year's session of the Seminar will be discussed again the various aspects related to the structure of old Albanian, as reflected in the old writings, and its structural features. Participants are encouraged to address in their studies concrete structural issues and problems related to the Old Albanian system.

2. Albanian and its varieties

Today's Albanian has manifestations of different varieties and linguistic forms which have different geographical, social and cultural support. Within this topic, participants are invited to address multidimensional issues related to Albanian varieties, their structure, functions and uses.

II. Literature:

1. Albanian literature: loneliness and isolation

These strong topics of universal literature with a permanent presence in literature, have traces and have become productive in Albanian literature. An investigation of traces and relations with the topics, poetics, periods, authors and genres of Albanian literature is possible. Loneliness and isolation also appear as prerequisites for creation in general and the literary one in particular.

Starting from these two major sections, Albanian literature can be investigated and interpreted in the light of:

- Loneliness as a precondition for research, discovery and creation of self and world;
- Loneliness and isolation as a construction and possession of self and personal identity;
- Separation from society as a hygienic distance from the "other" (also the one that can be detected precisely from loneliness and isolation) to discover the limits of oneself;

- Lack of social segregation as a precondition and product of mass literature;
- Loneliness and isolation of the creative individual from society, the phenomenon of literary "isms" of the twentieth century, even in Albanian literature.

2. Teaching literature to students of the new millennium

This topic focuses on the idea of teaching literature to a new generation of students who are considered "born" with new technologies i.e., students of the new millennium who have a completely different approach to the book and readings by their teachers, but also in general with "immigrants", as they are called all those individuals who have learned and adopted new technologies with them from an early age. Based on this premise, the teaching of literature has reflected and is reflecting in the world. What about this approach in Albanian-speaking areas at all levels: programs, textbooks, teachers, as well as master programs that graduate literature teachers?

The case of digital teaching during the pandemic period, more than a year at all levels of literature teaching can serve as a casus to analyze some of the above issues.

III. Culturology:

1. The role of the media in the infodemic period

The word 'infodemy', first mentioned in a Washington Post article in 2003, was reused by the World Health Organization in February of last year as a 'mass infodemy', which is accompanying the outbreak of the Covid pandemic. This term for the WHO means the flood of information about the virus, some of which are inaccurate and make it difficult to find verified sources for the public.

In the era of post-truth, populist discourse, and the dizzying development of digital technology, it is becoming increasingly difficult to distinguish factual information from propaganda. Misinformation about the coronavirus is spreading as fast as the virus itself, from the miraculous alternative medicine to anti-vaccination activism and conspiracy theories. Fake news, which is often second-hand or third-rate, goes viral, especially on social media, and few in the public spend those 20 seconds washing their hands and verifying the source or simply searching on Google. Infodemy causes powerful emotional effects, leaving aside rational judgment and critical thinking.

What is the role of the media in this infodemic chaos?

2. Fake news in the era of self-communication

Today we have already passed from the era of communication to that of self-communication, when individuals become both givers and receivers of messages. One of the problems that commonly appears in this era of self-communication is fake news that has become a phenomenon in the world today. The ways of investigation and detection of fake news, the report of fake news with traditional and new media, the reaction to it and the consequences it creates in communication and self-communication can be some of the perspectives from which one can see the phenomenon of fake news in the era of self-communication.

Abstracts of maximum 300 words in Albanian and English should be sent to the e-mail address: seminari.filologjik@uni-pr.edu. The deadline for submission is the **20th of July, 2021**. The abstracts should include the research topic and aim of the study, materials and methodology as well as the expected outcomes. Please include the author's affiliation and a brief biography. Notification regarding abstract acceptance will be sent to the submitting author until July 25th 2020.

Researchers from Albania should apply in the Co-Directory of the Seminar in Tirana (e-mail: lindameniku@gmail.com).

In addition, we invite scholars who will not be able to be part of this year's Seminar in order to present their scientific work to submit their papers for publication in the journal of the 39th Seminar. Papers which must contain the abstract in Albanian and in English should be sent to the e-mail address: seminari.filologjik@uni-pr.edu.

The deadline for submission is the 1st of December, 2020. Only papers that will be considered publishable by blind peer reviewers will be published.

The Seminar Directory